

**Marreveshje Transferimi
te Pjeseve te Kapitalit te shoqerise "ALDAFA" Sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me 13/06/2023, palet e kesaj Marreveshjeje rane dakort si me poshte:

Shitesi:

- **Z. Erjon Çejku**, shtetas shqiptar, lindur me 13/05/1989, ne Kukës, banues ne Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit Nr. personal I90513075C, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

(me poshte referuar "SHITESI")

dhe

Bleresi:

- **Z. Genti Prenda**, shtetas shqiptar, lindur me 04/09/1980, ne Kuçove, banues ne Tirane, mbajtes i Kartes se Identitetit me Nr. personal I00904112P, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

(me poshte referuar "BLERESI")

MEQENESE:

- A. Shitesi zoteron 100% te Kapitalit te Shoqerise "**ALDAFA**" **Sh.p.k**, nje shoqeri ekzistuese sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT L42228010L, me seli ne: Rruga "Gjin Bue Shpata", Kati II-të, Nr.Pasurie 1/181/ND+N3, (pranë ish Urgjencës), Tiranë, ("Shoqeria") me nje kapital prej 100.000 lek, i perbere nga 1 kuote.
- B. Bleresi deshiron te bleje 100% Kapitalit te Shoqerise te zoteruar nga Shitesi ne shoqerine e lartpermendur "**ALDAFA**" **Sh.p.k**, siç percaktohet ne kete marreveshje.
- C. Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe nenet e Statutit te Shoqerise, Asambleja e Ortakeve te shoqerise ka marre vendimin perkates per transferimin tek Bleresi te kuotave si me siper.

PER SA ME SIPER, palet bien dakort si me poshte:

1. Shitesi pranon se ka marre nga Bleresi ne menyre te plote te gjithë çmimin e blerjes te rene dakord ne vleren nominale te kuotes, prej Lekë 100.000 (njqind mijë lekë) dhe per kete arsye transferon ketu 100% te Kapitalit te zoteruar nga Shitesi ne Kapitalin e Shoqerise "**ALDAFA**" **Sh.p.k.**, ne pronesi te Bleresit.
Shitesi deklaron dhe garanton Bleresin se 100% e kapitalit qe transferohet ketu eshte ne pronesine e tij te plote ligjore dhe te lira nga barra, hipoteke apo pengje.
2. Bleresi pranon pronesine e 100% te kuotave te kapitalit te shoqerise, dhe bie dakord me te gjitha te drejtat dhe detyrimet e lindura nga zoterimi i ketyre kuotave brenda Shoqerise, sipas percaktimeve te Statutit te Shoqerise dhe ligjit shqiptar.

3. Me nenshkrimin e kesaj Marreveshje, ortakë të shoqërisë dhe pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në shoqërinë “**ALDAFA**” Sh.p.k. do të jenë:

- **Z. Genti Prenda**, - zotëron 100% të kapitalit të shoqërisë

4. Shitesit dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të këtyre Kuotave objekt të kësaj Marreveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Marreveshje u hartua në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Marreveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

Marreveshja u lexua nga palët, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre.

SHITESI

Erjon ÇEJKU

Erjon Çejku 

BLERESI

Genti PRENDA

GENTI PRENDA 